Emri dhe Andresa e plote Alb-Star shpk

Zona Industriale Patos Fier Albania

Tel.0682021997 &0682032785

info@albstar.com & www.albstar.com

Ndërtim Imp Exp ALB STAR Fier Albania

Data e krijimit **15 shkurt 1995**

Nr. i Regjistrit tregeta **1000134**

STATUSI JURIDIK Shoqeri me pergjegjesi te kufizuar

VEPRIMTATRIA KRYESORE : **NDERTIM**

LLOGARITE VJETORE

(Gjendjet Financiare)

PERIUDHA NGA 01,01,2008 deri me 31,12,2008

DATA E MBYLLJES **24.03.2009**

MIRATUAR NGA Hetem Sulaj ekspert

Me date _____ **25.03.2009**

Data e depozitimit _____

Tabela e përmbajtjes

A. RAPORTI I AUDITUESIT TE PAVARUR 0

B. BILANCI KONTABEL 2

C. PASQYRA E TE ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE 3

D. PASQYRA E FLUKSIT TE PARASE 4

E. PASQYRA E NDRYSHIMEVE NE KAPITALET E VETA 5

F. SHENIME PER PASQYRAT FINANCIARE 6-15

Ndërtim Imp Exp ALB STAR Fier Albania

ALB-STAR SH.P.K

BILANCI KONTABEL
Për vitet ushtrimor te mbyllur më 31 Dhjetor 2008 dhe 2007
(Të gjitha balancat janë në lekë)

		Shenimi nr.	Ushtrimi i mbyllur 31.12.2008	Ushtrimi i mbyllur 31.12.2007
A	**AKTIVET**			
I	**Aktive Afatshkurtera**			
	Aktive monetare	3	173,958,086	216,167,618
	Derivativë dhe aktive të mbajtura për tregtim		-	-
	Aktive të tjera financiare afatshkurtra	4	326,820,409	211,603,753
	Inventari	5	4,709,348	3,123,701
	Aktivet afatshkurtra të mbajtura për shitje		-	-
	Parapagimet dhe shpenzimet e shtyra		-	
	Totali i Aktiveve Afatshkurtera(I)		505,487,843	430,895,072
II	**Aktive Afatgjata**			
	Investimet financiare afatgjata		-	-
	Aktive afatgjata materiale	6	816,285,394	509,496,022
	Aktivet afatgjata jomateriale		-	-
	Kapital aksionar i papaguar		-	-
	Aktive të tjera afatgjata		-	-
	Totali i Aktiveve Afatgjata(II)		816,285,394	509,496,022
	TOTALI I AKTIVEVE (I + II)		**1,321,773,237**	**940,391,094**
B	**DETYRIMET DHE KAPITALI**			
I	**Detyrime Afatshkurtera**			
	Huamarrjet	7	7,773,842	-
	Huatë dhe parapagimet	8	240,999,874	299,122,576
	Grantet dhe të ardhurat e shtyra		-	-
	Provizionet afatshkurtra		-	-
	Totali i Detyrimeve Afatshkurtera (I)		248,773,716	299,122,576
II	**Detyrime Afatgjata**			
	Huatë afatgjata	9	-	-
	Huamarrje të tjera afatgjata(Ortak)		-	52,281,902
	Provizionet afatgjata		-	-
	Grantet dhe të ardhurat e shtyra		-	-
	Totali i Detyrimeve Afatgjata (II)		-	52,281,902
	Totali i Detyrimeve (I+II)		248,773,716	351,404,478
III	**Kapitali**			
	Kapitali i rregjistruar (aksionar)	10	85,000,000	85,000,000
	Primi i aksionit		-	-
	Njësitë ose aksionet e thesarit (negative)		-	-
	Rezerva statutore		-	-
	Rezerva ligjore	10	4,403,469	4,403,469
	Rezerva të tjera	10	-	-
	Fitimet(humbja) te pashpërndara	10	399,583,147	146,266,510
	Fitimi (humbja) e vitit financiar	11	584,012,905	353,316,637
	Totali i Kapitalit (III)		1,072,999,521	588,986,616
	TOTALI I DETYRIMEVE E KAPITALIT (I,II,III)		**1,321,773,237**	**940,391,094**

Shenimet shoqeruese 1 deri ne 15 jane pjese perberse e ketyre pasqyrave financiare

Ndërtim Imp Exp ALB STAR Fier Albania

ALB-STAR SH.P.K

PASQYRA E TE ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE
Për vitet ushtrimor te mbyllur më 31 Dhjetor 2008 dhe 2007
(Të gjitha balancat janë në lekë)

		Shenimi nr.	Ushtrimi i mbyllur 31.12.2008	Ushtrimi i mbyllur 31.12.2007
1	Shitjet neto	11	1,833,298,533	1,441,793,648
2	Të ardhura të tjera nga veprimtaritë e shfrytëzimit(Pu	.	103,202,216	101,887,517
3	Ndryshimet në inventarin e produkteve të gatshme dl	.	-	-
4	Materialet e konsumuara,mallrat dhe sherbimet	11	736,117,214	711,362,692
5	Kosto e punës	11	151,186,077	73,027,094
	Pagat e personelit		132,905,926	54,947,435
	Shpenzimet per sigurimet shoqërore dhe shëndetsore		18,280,151	18,079,659
6	Amortizimet dhe zhvlerësimet		84,433,692	52,481,569
7	Shpenzime të tjera		313,879,526	263,739,108
8	**Totali i shpenzimeve (shuma 4 - 7)**		**1,285,616,509**	**1,100,610,463**
9	**Fitimi apo humbja nga veprimtaria kryesore (1+2+/-3-8)**		**650,884,240**	**443,070,702**
10	Të ardhurat dhe shpenzimet financiare nga njësitë e kontrolluara		-	-
11	Të ardhurat dhe shpenzimet financiare nga pjesëmarrjet		-	-
12	Të ardhurat dhe shpenzimet financiare	**11**	**(581,506)**	**(1,424,906)**
	12.1 Të ardhurat dhe shpenzimet financiare nga investime të tjera financiare afatgjata		-	-
	12.2 Të ardhurat dhe shpenzimet nga interesat 767, 667		-	-
	12.3 Fitimet (humbjet) nga kursi i këmbimi 769, 669		(581,506)	(1,424,906)
	12.4 Të ardhura dhe shpenzime të tjera financiare 768, 668		-	-
13	**Totali i të ardhurave dhe shpenzimeve financiare**		(581,506)	(1,424,906)
14	**Fitimi (humbja) para tatimit (9+/-13)**		**650,302,734**	**441,645,796**
15	**Shpenzimet e tatimit mbi fitimin 69**	12	**66,289,829**	**88,329,159**
16	**Fitmi (humbja) neto e vitit financiar (14-15)**	11	**584,012,905**	**353,316,637**
17	**Elementët e pasqyrave të konsoliduara**		-	-

Ndërtim Imp Exp ALB STAR Fier Albania

ALB-STAR SH.P.K

PASQYRA E RRJEDHJES SE PARASE (cash flow)
Për vitet ushtrimor te mbyllur më 31 Dhjetor 2008 dhe 2007
(Të gjitha balancat janë në lekë)

	Shenimi nr.	Ushtrimi i mbyllur 31.12.2008	Ushtrimi i mbyllur 31.12.2007
Fluksi monetar nga veprimtaritë e shfrytëzimit			
Fitimi para tatimit		650,302,734	441,645,796
Rregullime për:		(201,289,202)	(61,105,027)
Amortizimin		84,433,692	52,481,569
Humbje nga këmbimet valutore		-	-
Të ardhura nga investimet		-	-
Shpenzime për interesa		-	-
Rritje/rënie në tepricën e kërkesave të arkëtueshme nga aktivit		(115,216,656)	21,297,818
Rritje/rënie në tepricën inventarit		(1,585,647)	(582,317)
Rritje/rënie në tepricën e detyrimeve, për t'u paguar nga aktiviteti		(102,630,762)	(45,972,938)
Mjete monetare të përfituara nga aktivitetet		-	-
Interesi i paguar		-	-
Tatim mbi fitimin i paguar		(66,289,829)	(88,329,159)
Mjete monetare neto nga aktivitetet e shfrytëzimit		449,013,532	380,540,769
Fluksi monetar nga veprimtaritë investuese			
Blerja e shoqërisë së kontrolluar X minus paratë e arkëtuara		-	-
Blerja e aktiveve afatgjata materiale		(391,223,064)	(277,432,650)
Të ardhura nga shitja e pajisjeve			-
Interesi i arkëtuar		-	-
Dividendët e arkëtuar		-	-
Mjete monetare neto e përdorur në aktivitetet investuese		(391,223,064)	(277,432,650)
Fluksi monetar nga veprimtaritë financiare			
Hyrje nga emetimi i kapitalit aksioner		-	-
Hyrje nga huamarrje afatgjata		-	-
Pagesat e detyrimeve të qirasë financiare		-	-
Dividendët e paguar		(100,000,000)	(4,000,000)
Mjete monetare neto e përdorur në aktivitetet financiare		(100,000,000)	(4,000,000)
KONTROLLI		(42,209,532)	99,108,119
Rritja/rënia neto e mjeteve monetare		**(42,209,532)**	**99,108,119**
Mjetet monetare në fillim të periudhës kontabël		**216,167,618**	**117,059,499**
Mjetet monetare në fund të periudhës kontabël		**173,958,086**	**216,167,618**

Ndërtim Imp Exp ALB STAR Fier Albania

ALB-STAR SH.P.K

PASQYRA E NDRYSHIMEVE NE KAPITAL
Për vitet ushtrimor te mbyllur më 31 Dhjetor 2008 dhe 2007
(Të gjitha balancat janë në lekë)

	Kapitali i rregjistruar (aksionar)	Primi i aksionit	Rezerva ligjore statusore	Fitimi pashpërndarë	Totali
Pozicioni më 31 Dhjetor 2006	85,000,000	-	4,403,469	150,266,510	239,669,979
Efekti ndryshimeve ne politikat kontabël	-	-		-	-
Pozicioni I rregulluar	-	-	-	-	-
Fitimi neto për periudhën kontabël				353,316,637	353,316,637
Dividentët e paguar				-	(4,000,000)
Rritje e rezervës së kapitalit	-		-	-	-
Emetimi i kuotave(aksioneve)	-	-		-	-
Pozicioni më 31 Dhjetor 2007	85,000,000	-	4,403,469	503,583,147	588,986,616
					-
Fitimi neto për periudhën kontabël	-	-	-	584,012,905	584,012,905
Dividentët e paguar	-	-	-	(100,000,000)	(100,000,000)
Emetim i kapitalit aksionar	-	-	-	-	-
Rritje e rezervës së kapitalit	-	-	-	-	-
Aksione te thesarit te riblera	-	-	-	-	-
					-
Pozicioni më 31 Dhjetor 2008	85,000,000	-	4,403,469	987,596,052	1,072,999,521

Këto pasqyra financiare janë aprovuar nga drejtimi i "**ALB-STAR " SH.P.K** dhe jane firmosur nga:

Administratori

Sadik ISMAILAJ

Financiere
Elsa Sema

Fier , me 25.03.2009

SHENIME PER PASQYRAT FINANCIARE
Për vitet ushtrimor te mbyllur më 31 Dhjetor 2008 dhe 2007
(Të gjitha balancat janë në lekë).

1. TE PERGJITHSHME

HISTORIA DHE KRIJIMI

" ALB-STAR " sh.p.k , eshte themeluar si nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar me vendim te gjykates se rrethit gjyqesor Tirane nr.8918 date 15 Shkurt 1995 me ortak te vetem z.Sadik ISMAHILAJ .
Me vendim te Gjykates se RRethit Gjyqesor Tirane nr. 8918/1 date 27 Qershor 2002 eshte bere shitja e e 50% te kuatave te kapitalit tek z. Idajet ISMAILAJ
Kapitali rregjistruar aktualisht eshte 85.000.000 leke dhe zotrohet teresisht nga ortaket e shoqerise :

- Z.Sadik ISMAILAJ 50% te kapitalit themeltar
- Z.Idajet ISMAILAJ 50% te kapitalit themeltar

Keto pasqyra financiare jane paraqitur ne leke Shqiptare (Leke) meqense kjo eshte monedha net e cilen jane kryer pjesa me e madhe e transaksioneve te Shoqerise .

AKTIVITET KRYESOR

Veprimtaria kryesore tregtare e shoqerise per ushtrimin 2008 jane sherbimet ne fushen e ndertimit..

DREJTUESIT

BORDI DREJTUES

EMRI	FUNKSIONI	VENDI
Sadik ISMAILAJ	Administrator	Fier
Elsa SEMA	Financiere	Fier

2. PERMBLEDHJE E POLITIKAVE KRYESORE KONTABEL

Bazat e pergatitjes së pasqyrave financiare

Pasqyrat financiare janë pergatitur në përputhje me ligjin shqiptar 'Për kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare" dhe me Standartet Kombëtare të Kontabilitetit (S.K.K) .
Pasqyrat financiare jane pergatitur mbi bazen e parimit te kostos historike, duke e kombinuar me elemente të metodave të tjera dhe parimit te te drejtave te kostatuara.
Pasqyrat financiare te shoqerise pergatiten cdo vit me 31 Dhjetor .

Standartet Kombëtare të Kontabilitetit zbatohen per here te pare dhe aplikimi i tyre, sipas kerkesave te SNK-ve, eshte bere ne menyre prospektive. Si pasoje shifrat e vitit 2008 nuk jane te krahasueshme me ato te vititt 2007, pasi jane zbatuar politika kontabel të ndryshme.
Ne paraqitjen e pasqyrave financiare te vitit 2008 eshte zbatuar formati i SKK-2 dhe per rrjedhim zerat e pasqyrave financiare te periudhes krahasuese 2007 jane riklasifikuar ne pershtatje me formatin e ri, ndryshime te cilat spjegohen ne shenimet ne vazhdim.

Nje permbledhje e politikave kryesore kontabel eshte paraqitur me poshte:

Njohja e te ardhurave dhe shpenzimeve

Ndërtim Tmp Exp ALB STAR Fier Albania

SHENIME PER PASQYRAT FINANCIARE
Për vitet ushtrimor te mbyllur më 31 Dhjetor 2008 dhe 2007
(Të gjitha balancat janë në lekë).

Të ardhurat dhe shpenzimet njihen sipas kontabilitetit të të drejtave të konstatuara.Të ardhurat nga shitja e mallrave dhe produkteve njihen kur i janë kaluar blerësit të gjitha rreziqet dhe përfitimet, maten me besueshmëri dhe ka siguri te mjaftushme ne marrjen e perfitimeve. Të ardhurat nga kryerja e shërbimeve njihen në varësi të fazës, në të cilën ndodhet kryerja e shërbimit në datën e bilancit dhe ardhurat dhe shpenzimet që lidhen me shërbimin mund të përllogaritet me besueshmëri.Të ardhurat vlerësohen me vlerën e drejtë të shumës së arkëtuar ose të arkëtueshme, duke marrë parasysh shumën e skontimeve ose rabatet e ofruara. Shpenzimet njihen atehere kur ato sigurohen prej te treteve dhe ne te njejtin ushtrim kontabel me te ardhurat e lidhura.

Monedhat e huaja

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në lekë, me kursin zyrtar të këmbimit të Bankës në datën e kryerjes së transaksionit. Në çdo datë bilanci,zërat monetarë të bilancit të shprehur në monedhë të huaj rivlerësohen me kursin zyrtar të këmbimit të në datën e bilancit. Zërat jomonetarë, të shprehur në monedhë të huaj, maten në termat e kostos historike dhe nuk rivlerësohen. Fitimi ose humbja e pa realizuar nga ndryshimi i kurseve të këmbimit njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.
Kurset e këmbimit, të përdorura nga shoqeria për monedhat e huaja më kryesore, më 31.12.2008 jane :

EURO : LEK 123.8

USD : LEK 87.91.

Kostot e huamarrjes

Kostot e huamarrjes perfshijne interesin e paradhenieve bankare dhe huave afatshkurtera dhe afatgjata . Kostot e huamarrjes njihen si shpenzim ne periudhen qe ato jane shkaktuar pavarsisht se si huate jane aplikuar .

Tatimin mbi fitimin

Shpenzimi per tatimin mbi fitimin perfaqson shumen e tatimit per tu paguar per vitin ushtrimor.Tatim fitimi i pagueshem per vitin aktual bazohet mbi fitimin e tatueshem per vitin . Fitimi i tatueshem ndryshon nga fitimi neto qe raportohet ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve sepse ai perjashton zera te te ardhurave dhe shpenzimeve qe jane te tatueshme apo te zbritshem ne vite te tjere dhe gjithashtu perjashton zera qe nuk jane kurre te tatueshem apo te zbritshem . Detyrimi i shoqerise per tatim fitimin e vitit llogaritet duke perdorur normat e tatimit te percaktuara nga legjislacioni shqiptar per kontabilitetin ne Shqiperi . Norma aktuale e tatimit mbi fitimin eshte 10 % (2007-20%)

Instrumentet financiar

Mjetet dhe detyrimet financiare njihen ne bilancin kontabel te shoqerise kur Shoqeria behet pale ne kushtet kontraktore per instrumentin .

Kërkesat për t'u arkëtuar

Kërkesat për t'u arkëtuar, të ardhurat e konstatuara dhe llogari të tjera afatshkurtra dhe afatgjata, për t'u arkëtuar në parà regjistrohen në bilanc me kosto të amortizuar. Kostoja e amortizuar e kërkesave për t'u arkëtuar afatshkurtra, në përgjithësi është e barabartë me vlerën e tyre nominale (minus provizionet e

Ndërtim Imp Exp ALB STAR Fier Albania

SHENIME PER PASQYRAT FINANCIARE
Për vitet ushtrimor te mbyllur më 31 Dhjetor 2008 dhe 2007
(Të gjitha balancat janë në lekë).

krijuara për rënie në vlerë), kështu që kërkesat afatshkurtra regjistrohen në bilanc me vlerën e tyre neto të realizueshme (e cila raportohet, për shembull në një faturë, kontratë ose dokument tjetër).

Detyrimet financiare

Detyrimet financiare jane klasifikuar sipas llojit te marrveshjes kontraktuale
Huat e marra, furnitorët, shpenzimet e konstatuara dhe huamarrje të tjera afatshkurtra dhe afatgjata, për t'u shlyer në parà, në përgjithësi, mbahen me koston e amortizuar në bilanc. Kostoja e amortizuar e pasiveve financiare afatshkurtra, në përgjithësi, është e barabartë me vlerën e tyre nominale; kështu që pasivet financiare afatshkurtra mbahen në bilanc në vlerën e tyre neto të realizueshme (për shembull, të raportuar në një faturë, kontratë ose dokument tjetër).

Risku I kreditimit

Risku I kreditimit te Shoqerise kryesisht I vishet kerkesave per arketim dhe aktiveve te tjera te saj . Gjendjet e paraqitura ne bilancin kontabel jane zvogeluar nga provigjonet (shumat e parashikuara) per kerkesat e dyshimta per arketim , te vleresuara nga drejtimi I shoqerise mbi bazen e experiences se meparshme dhe vleresimit te mjedisit ekonomik actual .
Shoqeria nuk ka perqendrim te rendesishem te riskut te kreditimit , me nje zbulim te shperndare ne nje numur te madh te tretesh dhe klientesh .

Aktivet afatgjata materiale (AAM-te)

Aktivet afatgjata materiale(AAM-të) paraqiten me shuma te rivleresuara minus zhvleresimin . Në bilanc, një element i AAM-së paraqitet me koston historike minus amortizimin e akumuluar dhe ndonjë humbje të akumuluar nga zhvlerësimi. Në se vlera kontabël e një aktivi afatgjatë material rritet, si rezultat i rivlerësimit, kjo rritje kreditohet drejtpërdrejt në kapitalet e veta nën zërin "tepricë nga rivlerësimi". Nëse vlera kontabël e një aktivi afatgjatë material zvogëlohet, si rezultat i rivlerësimit, ky zvogëlim njihet si shpenzim në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Amortizimi eshte llogaritur mbi bazen e metodes lineare per ndertesat dhe mbi bazen e vleren se mbetur per pjesen tjeter te aktiveve afatgjata materiale , duke ngarkuar pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve si me poshte .
Normat e aplikuara per vitet 2008 dhe 2007 jane :

Ndertesa	5%
Instalime teknike dhe makineri	20%
Mjete transporti	20%
Paisje zyre	20%
Paisje informatike	25%

Inventaret

Inventaret jane paraqitur me vleren me te ulet midis kostos dhe vleres neto te realizueshme .
Kosto perbehet nga materiale direkte dhe , ne rastet kur eshte e aplikueshme , kostot e punes direkte dhe ato kosto te pergjithshme qe jane ndeshur per te sjelle inventare ne vendin dhe kushte aktuale magazinimi . Kosto eshte llogaritur duke perdorur metoden e mesatares se ponderuar .
Vlera neto e realizueshme perfaqson cmimin e vleresuar te shitjes minus kostot e vleresuara te perfundimit dhe kostot e marketingut , shitjes dhe shperndarjes .
Gjendjet e inventarit ne pasqyrat financiaret paraqiten me kostot e blerjeve te fundit te ushtrimitt qe nga drejtimi eshte çmuar si vlera neto te realizueshme.

Ndërtim Imp Exp ALB STAR Fier Albania

SHENIME PER PASQYRAT FINANCIARE
Për vitet ushtrimor te mbyllur më 31 Dhjetor 2008 dhe 2007
(Të gjitha balancat janë në lekë).

3. Aktive monetare (likujditete në arke dhe bankë)

Gjendjet e mjetet monetare ne banke dhe arke, ne leke dhe valute, ne datat 31 Dhjetor 2008 dhe 31 Dhjetor 2007 jane si me poshte:

Emertimi i Llogarise	Monedha	Gjendja ne 31.12.2008		Gjendja ne 31.12.2007	
		Ne leke	Ne valute	Ne leke	Ne valute
Llogari bankare	LEK	67,211,801	-	216,167,618	-
Llogari bankare	LEK	103,900,038	839257 E		
Llogari bankare	LEK	2,846,247	32377$	0	-
Arka ne leke	LEK	8,530	-		
Shuma		173,958,086	x	216,167,618	x

Gjendjet e llogarive te likujditeteve te paraqitura ne pasqyrat financiare jane te njejta me te dhenat e kontabilitetit rrjedhes dhe konfirmohen me nxjerrjet e llogarive bankare dhe inventaret fizike te monedhave.Tepricat e shprehura në monedhë të huaj, jane konvertuar ne leke duke përdorur kursin e këmbimit të fundit te ushtrimit te bankes respektive.

4. Aktive të tjera financiare afatshkurtra

Kerkesat e arketueshme dhe aktive te tjera financiare, ne fillim dhe ne fund te ushtrimit kontabel 2008 deklarohen si vijon:

	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2008	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2007
Aktive të tjera financiare afatshkurtra		
(i) Llogari / Kërkesa të arkëtueshme	316,928,904	211,603,753
(ii) Llogari / Kërkesa të tjera të arkëtueshme	9,891,505	0
(iii) Instrumente të tjera borxhi	0	0
(iv) Investime të tjera financiare	0	0
Shuma	326,820,409	211,603,753

Ne "Llogari / Kërkesa të arkëtueshme " jane pasqyruar vlerat e akumuluara te kerkesa te arketueshme ndaj klienteve per shitjen e mallrave dhe sherbimeve .
Shumat e paraqitura ne "Llogari / Kërkesa të tjera të arkëtueshme perfaqesojne tepricen kreditore te "Shteti-TVSH" me 31.12.2008 me 9.891.505 leke e cila rakordon me FDP-ne e muajit Dhjetor 2008 .

Drejtimi mendon se te gjitha kerkesat do te arketohen ne nje periudhe afatshkurter me vleren e tyre nominale dhe nuk parashikon renie ne vlere.

Ndërtim Imp Exp ALB STAR Fier Albania

SHENIME PER PASQYRAT FINANCIARE
Për vitet ushtrimor te mbyllur më 31 Dhjetor 2008 dhe 2007
(Të gjitha balancat janë në lekë).

5. Inventari

Gjendjet e inventarit ne fillim dhe fund te ushtrimit paraqiten:

	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2008	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2007
Inventari		
(i) Lëndët e para	4,709,348	3,034,497
(ii) Prodhim në proces	-	-
(iii) Produkte të gatshme	-	-
(iv) Mallra për rishitje	-	-
(v) Parapagesat për furnizime(INVENTAR)	-	89,204
Shuma	4,709,348	3,123,701

Vlerat e inventarit te paraqitura me siper perputhen me te dhenat e kontabilitetit dhe te inventarizimeve fizike e kryer ne fund te ushtrimit 2008. Veprimet ekonomike qe lidhen me hyrjet e daljet jane tranzituar ne llogarite e rezultatit me menyren e inventarit te ndermjetem. Si politike kontabel ne percaktimin e kostos se inventarit eshte perdorur metoda "FIFO".Vlera e inventarëve të njohura si shpenzim gjatë periudhës kontabël 2008 eshte 736.117.214 leke.
Shuma e inventarit te paraqitur ne " Lëndët e para" perfaqson stokun e materialeve qe perdoren ne procesin e sherbimeve per te trete .
Drejtimi mendon se vlera e paraqitur eshte vlera me e ulet mes kostos se marrjes dhe vleres neto te realizueshme dhe nuk eshte nevoja per zhvleresime te tij.

6. Aktivet Afatgjata Materiale(AAM-te)

Gjendjet dhe levizjet e aktiveve afatgjata materiale ne pasqyrat financiare paraqitet si vijon:

Ne 000/Leke

	Gjendjet dhe levizjet	Toka	Ndertesa	Makineri dhe paisje	Aktivet te tjera afatgjata materiale	Totali
A	Kosto e AAM-ve me 01.01.2008	64,120	160,273	134,668	270,757	629,818
	Shtesat	69,960	102,935	134,831	129,805	437,531
	Pakesimet	-	-	(45,391)	(1,250)	(46,641)
	Kosto e AAM-ve 31.12.2008	134,080	263,208	224,108	399,312	1,020,708
B	Amortizimi AAM-ve 01.01.2008	-	5,667	56,121	58,534	120,322
	Amortizimi ushtrimit		9,894	24,039	50,501	84,434
	Amortizimi per daljet e AAM-ve	-	-	-	(333)	(333)
	Amortizimi i AAM-ve 31.121.2008	-	15,561	80,160	108,702	204,423
						-
C	Zhvleresimi AAM-ve 01.01.2008	-	-	-	-	-
	Shtesat	-	-	-	-	-
	Pakesimet	-	-	-	-	-
	Zhvleresimi AAM-ve 31.12.2008	-	-	-	-	-
D	Vlera neto e AAM-ve 01.01.2008	64,120	154,606	78,547	212,223	509,496
						-
	Vlera neto e AAM-ve 31.12.2008	134,080	247,647	143,948	290,610	816,285

Ndërtim Imp Exp ALB STAR Fier Albania

SHENIME PER PASQYRAT FINANCIARE
Për vitet ushtrimor te mbyllur më 31 Dhjetor 2008 dhe 2007
(Të gjitha balancat janë në lekë).

Vlerat dhe klasifikimi ne grupe i AAM-ve te pasqyruara ne bilanc dhe ne tabelen e mesiperme jane te perputhura me te dhenat e kontabilitetit dhe te inventarizimeve fizike qe shoqeria e ka kryer ne fund te muajit dhjetor 2008.Si politike kontabel per kontabilizimin dhe spjegimin e AAM-ve, shoqeria ka zgjedhur modelin e kostos(SNK-5).Vleresimi fillestar ne momentin e marrjes ne inventar eshte bere me koston e marrjes dhe ne daten e mbylljes se bilancit paraqiten me koston e tyre minus amortizimin e akumuluar dhe ndonje humbje te akumuluar nga zhvleresimi.
Drejtimi mendon se pergjithesisht per kete ushtrim kontabel, nuk ka shenja te renjes ne vlere te AAM-ve dhe nuk ka llogaritur zhvleresime.
Metodat dhe normat e amortizimit te AAM-ve te perdorura jane njejta me ato qe perdoren per qellime fiskale.(shih shenimin nr.2)Masa e llogaritur e amortizimit si shpenzim nuk i tejkalon kufijte e njohur per efekte fiskale.

7. Detyrime afatshkurtera-Huamarrjet

Huate dhe parapagimet afateshkurtera ne fillim dhe ne fund te ushtrimit kontabel 2008 paraqiten si vijon:

	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2008	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2007
Huamarrjet		
(i) Huatë dhe obligacionet afatshkurtra	7,773,842	0
(ii) Kthimet / ripagesat e huave afatgjata	0	0
(iii) Bono të konvertueshme	0	0
Shuma	7,773,842	0

" Huate afatshkurtera " perfaqeson kredinje ne forme overdrafti te marre nga Union Bank ne 70.000 Euro per blerje mjete transporti per nevoja te shoqerise .

8. Detyrime afatshkurtera-Huate dhe parapagimet

Huate dhe parapagimet afateshkurtera ne fillim dhe ne fund te ushtrimit kontabel 2008 paraqiten si vijon:

	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2008	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2007
Huate dhe parapagimet		
(i) Te pagueshme ndaj Furnitoreve	204,195,603	223,459,558
(ii)Te pagueshme ndaj Punonjesve	9,498,493	5,361,829
(iii)Detyrime tatimore	27,305,778	70,301,190
(iv)Huara te tjera	0	0
Parapagimet e arketuara	0	0
Shuma	240,999,874	299,122,577

"Të pagueshme ndaj furnitorëve" pasqyron detyrimet ndaj furnitoreve per blerjen e mallrave e sherbimeve pa u likujduar ne fund te ushtrimit.Shoqeria ka pergatitur inventaret kontabel dhe shuma e llogarise sintetike eshte e barabarte me shumen e llogarive analitike te mbajtura per cdo furnitor.
Drejtimi mendon se te drejtat e furnitoreve jane te vleresuara realisht.

Ndërtim Imp Exp ALB STAR Fier Albania

SHENIME PER PASQYRAT FINANCIARE
Për vitet ushtrimor te mbyllur më 31 Dhjetor 2008 dhe 2007
(Të gjitha balancat janë në lekë).

"Të pagueshme ndaj punonjësve" perbehet nga detyrimi i papaguar ndaj personelit ne 31.12.2008. "Detyrimet tatimore+sig.shoqerore" perfaqesojne detyrimin per tatimin mbi fitimin ne shumen 22.920.618 leke, tatimin mbi te ardhurat personale (TAP) ne shumen 1.795.731 leke dhe per sigurimet shoqerore e shendetesore te muajit dhjetor 2008 ne shumen 2.589.429 leke.

9. Detyrime Afatgjata-Huate afatgjata

Huate afatgjate ne fillim dhe ne fund te ushtrimit kontabel 2008 paraqiten si vijon:

	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2008	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2007
DETYRIME AFATGJATA		
I-Huatë afatgjata		
(i) Hua, bono dhe detyrime nga qeraja financiare	0	0
(ii) Bonot e konvertueshme	0	0
Shuma (I)	0	0
2-Huamarrje te tjera afatgjata		
3-Provizione afatgjata		
4-Grantet dhe te ardhurat e shtyra		
TOTALI I DETYRIMEVE AFATGJATA(1-4)	0	0

Shoqeria nuk konstaton detyrime afatgjata-Huate afatgjata per ushtrimin 2008 .

10. Kapitalet e veta

Kapitali i rregjistruar i shoqerise, i paraqitur ne bilanc, eshte i njejte me ate te percaktuar ne vendimet e depozituara ne QKR. Me 31.12.2008 ai eshte 85.000.000 leke, i ndare ne 85.000 kuota me vlere nominale 1.000 leke /kuota. Kapitali rregjistruar aktualisht eshte 85.000.000 leke dhe zotrohet teresisht nga ortaket e shoqerise :

- Z.Sadik ISMAILAJ 50% te kapitalit themeltar
- Z.Idajet ISMAILAJ 50% te kapitalit themeltar

Gjate ushtrimit kontabel 2008 nuk ka rritje ose pakesim ne kapitalin e rregjistruar te shoqerise dhe ne raportet zoterimit nga ortaket.

11. Fitimi (humbja) e vitit financiar

- **Te ardhurat**

Te ardhura e realizuara gjate ushtrimit, sipas segmenteve(kategorive) te biznesit paraqitet si vijon:

Ndërtim Imp Exp ALB STAR Fier Albania

SHENIME PER PASQYRAT FINANCIARE
Për vitet ushtrimor te mbyllur më 31 Dhjetor 2008 dhe 2007
(Të gjitha balancat janë në lekë).

	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2008	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2007
Te ardhurat		
Te ardhurat nga shitja e produkteve (701)	115,168,667	256,870,524
Te ardhurat nga shitja e punimeve dhe sherbimeve(704)	1,696,846,864	1,082,481,245
Te ardhurat nga shitja e mallrave (705)	21,283,003	99,361,606
Te ardhurat nga shitja materialesh e furniturash(707)	0	0
Te ardhura nga shitje te tjera 708)	266,667	3,080,273
Prodhim I AAM (722)	102,935,548	101,887,517
Te ardhurat nga Grantet (73)	0	0
Te ardhura nga shitja AAM (722)	0	0
Te ardhura te tjera (kontroll tatimor)	0	0
Shuma	1,936,500,749	1,543,681,165

Të ardhurat nga shitja e mallrave dhe produkteve jane vlerësuar me vlerën e drejtë të shumës së arkëtuar ose të arkëtueshme, duke marrë parasysh shumën e skontimeve ose rabatet e ofruara, te zhveshura nga TVSH-ja.Të ardhurat nga sherbimet e ndertimit ne infrastrukture, jane vlerësuar me vlerën e drejtë të shumës së arkëtuar ose të arkëtueshme, duke marrë parasysh shumën e skontimeve ose rabatet e ofruara, te zhveshura nga TVSH-ja.
Paraqitja ne pasqyrat financiare e te ardhurave dhe shpenzimeve eshte bere sipas natyres se tyre.

- **Shpenzimet e veprimtarise kryesore**

	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2008	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2007
4-Materialet e konsumuara		
a-Lende te para (601-608)	736,117,214	711,362,692
b-Produkte	0	0
c-Mallra (601-608)	0	0
d-	0	0
Shuma	736,117,214	711,362,692
7-Shpenzime te tjera (61-63)		
a-Sherbime nga te tretet (nenkontraktor) 611	123,792,791	112,449,401
b-Qera (613)	9,027,921	6,708,120
c-Mirmbajtje dhe riparime (615)	882,744	0
d-Sigurime (616)	8,607,427	3,007,755
e-Kerkime dhe studime (617)	0	0
f-Te tjera (618)	6,352,671	4,935,080
g-Personel jashte njesise (621)	0	0
h-Komisione te ndermjetme dhe honorare (622)	6,387,142	740,455
j-Shpenzime per koncesione , patent (623)	0	0
k-Publicitet reklam (624)	80,000	0
l-Transferime udhetim e dieta (625)	34,467,296	29,025,574
m-Shpenzime postare dhe telekomunikacioni (626)	9,885,277	9,354,246
n-Shpenzime transporti (627)	93,310,427	85,000,000
o-Sherbime bankare (628)	5,526,283	3,861,505
p-Tatime dhe taksa (632-638)	1,664,453	4,206,280
q-Vlera kontabel e AAM te shitura (672)	917,542	733,306
r-Shpenzime pritje dhe perfaqsimi (654)	12,510,949	
s-Subvecione te dhena (653)	382,000	0
t-Gjoba dhe demshperblime (657)	84,603	3,717,386
	0	0
Shuma	313,879,526	263,739,108

Ndërtim Imp Exp ALB STAR Fier Albania

SHENIME PER PASQYRAT FINANCIARE
Për vitet ushtrimor te mbyllur më 31 Dhjetor 2008 dhe 2007
(Të gjitha balancat janë në lekë).

Konsumi i materialeve,mallrave, furniturave, punimeve e sherbimeve, te pasqyruara ne dokumentat justifikues, jane rregjistruar me shumat e paguara ose te pagueshme.
Kostoja e punesimit, page dhe sigurime shoqerore, eshte pasqyruar saktesisht si shpenzim me vleren e realizuar dhe te dokumentuar.
Taksat lokale e taksa e tatime te tjera qe lidhen me biznesin jane llogaritur dhe pasqyruar ne llogarite e ushtrimit.
Shpenzimet e tjera qe ne nje mase te konsiderueshme perbehen nga Furnitura , nentrajtime dhe sherbime nga te trete paraqitet e analizuar sipas pasqyres se mesiperme .
Sipas natyres se tyre shpenzimet e ushtrimit 2008 jane treguar ne pasqyren perkatese.

- **Te ardhurat dhe shpenzimet financiare**

Jane paraqitur si diference e te ardhurave me shpenzimet sipas kerkesave te standarteve.

	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2008	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2007
Të ardhurat nga interesat 767, 667(+)	0	0
Shpenzimet per interesat 767, 668(-)	-	-
Fitimet nga kursi i këmbimi 769, 669(+)	-	-
Humbjet nga kursi i këmbimi 769, 670(-)	(581,506)	-
Të ardhura dhe shpenzime të tjera financiare 768, 668	-	-
Shuma	(581,506)	-

- **Shpenzime personeli**

Numri mesatar i punonjesve dhe pagat sipas kategorite kryesore jane si me poshte :

Ne 000/Leke

Kategorite	Ushtrimi 2008		Ushtrimi 2007	
	Numer mesatari	Paga gjithsej	Numeri mesatar	Paga gjithsej
Administrator, menaxher	2	13,542	2	14,761
Specialist me arsim universitar	43	48,615	15	12,308
Teknike	22	7,635	22	5,220
Puntor	220	49719	138	22,658
Shuma	287	119,511	177	54,947

Ndërtim Imp Exp ALB STAR Fier Albania

SHENIME PER PASQYRAT FINANCIARE
Për vitet ushtrimor te mbyllur më 31 Dhjetor 2008 dhe 2007
(Të gjitha balancat janë në lekë).

12. Shpenzimet e tatimit mbi fitimin

Shpenzimet e tatimi mbi fitimin per ushtrimin kontabel 2008 dhe 2007 jane si vijon:

		Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2008	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2007
I	FITIMI NETO PARA TATIMIT	650,302,734	437,928,410
II	SHPENZIME TE PAZBRITESHME (+)	12,595,552	3,717,386
1	Amortizime tej normave fiskale	-	-
2	Shpezime pritje e dhurime tej kufirit tatimor	-	-
3	Gjoba,penalitete,demshperblime	84,603	-
4	Provizione qe nuk njihen	-	-
5	Shpenzime pa dok. ose jo te rregullta	12,510,949	3,717,386
6	Te tjera-materiale jashte perdorimit(pa miratim)	-	-
III	PJESA E HUMBJES SE MBARTUR(-)	-	-
IV	FITIMI (HUMBJA) TATIMORE(I+II-III)	662,898,286	441,645,796
V	Shpenzimi i tatim fitimit-10%	66,289,829	88,329,159
VI	FITIMI NETO I USHTRIMIT(I-V)	584,012,905	349,599,251

Tatim fitimi i ushtrimit eshte i llogaritur mbi fitimin e tatushem, i cili eshte rregulluar nga shpenzimet e panjohura sipas legjistacionit fiscal, analizuar ne tabelen e mesiperme.

13. Transaksione te paleve te lidhura

Ne marrjen ne konsiderate te çdo transaksione dhe marredhenie te mundeshme, jo thjesht formen ligjore te tyre , ne 31 dhjetor 2008 dhe 31 Dhjetor 2007 nuk ka transaksione me palet e lidhura.

14. Ngjarjet pas dates se bilancit dhe vazhdimesia e shfrytezimit

Asnje ngjarje e rendesishme nuk ka ndodhur pas dates se miratimit te pasqyrave financiare.
Nga analiza e gjendjes dhe performances financiare te shoqerise, rezulton se ne ushtrimin 2008 eshte rritur shifra e afarizmit dhe fitimi tregtar. Raportet e rentabilitetit per vitin 2008 jane: Fitimi mbi shitjet para shpenzimeve financiare(intresave) 35.5 %, fitimi neto mbi shitjet para tatim fitimit 35.45 %.

15. Shifrat krahasuese

Shifrat krahasuese te deklaruara ne pasqyrat financiare 2007 jane riklasifikuar per tu pershtatur prezantimit te pasqyrave financiare te vitit aktual, te cilat jane ndertuar sipas SNK-ve qe aplikohen per here te para dhe ne menyre prospektive.(shih shenimin nr.2)

Ndërtim Imp Exp ALB STAR Fier Albania

Ekspert Kontabël i Autorizuar

Hetem SULAJ
Licenca profesionale I E K A
Nr.017, date 10.02.2000

Raport i Audituesit të Pavarur

Asamblese se Ortakeve të shoqerisë " ALB-STAR " sh.p.k

Adresa: Fier

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të shoqërisë "ALB-STAR " sh.p.k , me poshte " Shoqeria " që permbajne bilancin kontabël më datë 31 Dhjetor 2008, si dhe pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve, fluksit te arkes dhe te ndryshimeve ne kapitalin e aksionereve per kete ushtrim dhe te tjera shenime sqaruese .

Pergjegjesite e Drejtimit per Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e sinqertë të këtyre pasqyrave financiare në përputhje me Standartet Shqipëtare të Raportimit Financiar (SKK) .

Kjo përgjegjësi përfshin: hartimin, vënien në zbatim dhe mbajtjen e kontrollit të brendëshëm të përshtatshëm për përgatitjen dhe paraqitjen e sinqerite të pasqyrave financiare të cilat nuk permbajne keqdeklarime materiale ,qoft si rezultat i mashtrimeve apo gabimeve ; zgjedhjen dhe zbatimin e parimeve te duhura kontabile ; dhe kryerjen e cmuarjeve kontabile te arsyeshme per rrethanat financiare .

Pergjegjesite e Audituesit te Pavarur

Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion për këto pasqyra financiare bazuar në auditimin tonë. Ne kemi kryer auditimin në përputhje me Standartet Ndërkombëtare të Auditimit. Këto standarte kërkojnë që ne të zbatojmë kërkesat etike dhe të planifikojmë e kryejmë auditimin tonë për të marrë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare janë pa anomali materiale.

Auditimi përfshin kryerjen e procedurave për të marrë evidencë auditimi rreth shumave dhe informacioneve të dhëna në pasqyrat financiare. Procedurat e zgjedhura varen prej gjykimit të audituesit,duke përfshirë vlerësimin e rreziqeve për anomali materiale në pasqyrat financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose të gabimit.

Në bërjen e këtyre vlerësimeve të rrezikut, audituesi merr në konsideratë kontrollin e brendëshëm përkatës të entitetit në përgatitjen dhe paraqitjen me sinqeritet të pasqyrave financiare në mënyrë që të hartojë procedurat e auditimit që janë të përshtatëshme për rrethanat, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit për efektivitetin e kontrollit të brendëshëm të entitetit.

Auditimi gjithashtu përfshin vlerësimin e përshtatëshmërisë së metodave kontabël të përdorura dhe logjikën e çmuarjeve kontabël të bëra nga drejtimi, si dhe për vlerësimin e paraqitjes së përgjithëshme të pasqyrave financiare.

Adresa: Rr. "Emin Durakui", pall. "Binjaket", kat.5/1, prane Stadiumit Dinamoi",Tiranë, cel. 069 20 42 251,email:hsulaj@yahoo.com

Ne besojmë se evidence e auditimit që ne kemi marrë është e mjaftueshme dhe e përshtatëshme për të bazuar opinionin tonë .

Opinioni

Duke qene se nje pjese e kerkesave per t'u arketuar dhe e detyrimeve per t'u paguar nuk njihen saktesisht, ne se ato jane kerkesa reale dhe te mundeshme per tu arketuar, apo detyrime qe kerkohen nga te tretet, njohja e te cilave mund te ndikoje ne trezultatin e shoqerise pozitivisht ose negativisht, per opinionin tonre perben nje pasiguri ne saktesine e rezultatit te ketij viti.

Sipas opinionit tonë me perjashtim të efekteve te rregullimeve, në qoftë se do të kishte ndonjë të tillë, që mund të ishin përcaktuar të nevojshme për t'u bindur përsa i përket te drejtave financiare dhe detyrimeve per tu paguart, pasqyrat financiare, japin një imazh të vërtetë dhe të sinqertë të gjëndjes financiare të shoqërisë `` ALB-STAR " sh.p.k në datën 31 Dhjetor 2008, të rezultatit të veprimtarisë për ushtrimin e mbyllur dhe janë në pajtim me Standartet Shqipëtare të Rraportimit Financiar.

Tiranë më 25.03.2009

AUDITUES
Hetem SULAJ

AUDIT I PAVARUR HETEM SULAJ
TIRANA - ALBANIA